REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 46/17
Datë/Datum. 17.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 46/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z.Nuhi Paçarizi - Kryetar, z.Ekrem Salihu - Referues, z.Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues: "PBC Sh.p.k" - Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë lidhur me kriteret, me titull: "Furnizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në makinerinë lëvizëse dhe pompa të derivateve për monitorimin e shpenzimeve të derivateve të naftës në KEK sh.a", me nr prok:"16/370/111", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës/, më datën 08.03.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet,** si e bazuar ankesa e OE "PBC Sh.p.k" - Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në makinerinë lëvizëse dhe pompa të derivateve për monitorimin e shpenzimeve të derivateve të naftës në KEK sh.a", me nr prok:"16/370/111", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Korporata Energjetike e Kosovës/.

II. **Anulohet,** njoftimi për kontratë i AK-së /Korporata Energjetike e Kosovës/, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në makinerinë lëvizëse dhe pompa të derivateve për monitorimin e shpenzimeve të derivateve të naftës në KEK sh.a", me nr prok: "16/370/111" dhe **anulohet në tërësi** ky aktivitet i prokurimit, kurse nëse AK-ja ka interes edhe më tutje për këtë aktivitet të prokurimit mund ta ritenderojë.

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Operatorit ekonomik ankues "PBC Sh.p.k" - Prishtinë, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që pretendimet ankimore janë të bazuara.

V. Obligohen operatorë ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:01.02.2017.

Kundër njoftimit për kontratë, operatori ekonomik "PBC Sh.p.k" - Prishtinë, me dt:12.02.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt:23.11.2017, autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "PBC Sh.p.k" - Prishtinë.

Operatori ekonomik ankues "PBC Sh.p.k" - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 16 shkurt 2017 me nr. 46/17, kundër njoftimit për kontratë lidhur me kriteret, lidhur aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi, instalimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në makinerinë lëvizëse dhe pompa të derivateve për monitorimin e shpenzimeve të derivateve të naftës në KEK sh.a", me nr prok:"16/370/111", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 7 i LPP-së -(barazia në trajtim/ jo Diskriminimi)
- Neni 28 i LPP-së -(Specifikimet teknike)
- Neni 20.4 i UOPP-së -
- Neni 108/A i LPP-së -(Konfidencialiteti)

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 01 mars 2017, i ka rekomanduar panelit shqyrtues që të Aprovojë si të Bazuar ankesën e OE "PBC Shpk"- Prishtinë, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të obligojë Autoritetin kontraktues qe të anuloj njoftimin për kontrat të dt:04.10.2016 dhe të RITENDEROJ këtë aktivitet të prokurimit (nëse edhe më tutje ka interes për këtë aktivitet të prokurimit, duke vendosur kritere në harmoni me dispozitat e LPP-së konkretisht në harmoni me nenin 7,28,69 të LPP-së .

Operatori ekonomik ankues "PBC Sh.p.k" - Prishtinë, me datë: 03 mars 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues, me datë 03 mars 2017 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 08.03.2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, vëzhgues nga OJQ "D PLUS", ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "PBC Sh.p.k"-Prishtinë, ka deklaruar: "Për pretendimet tona ankimore janë dhënë provat që gjenden në shkresat e lëndës, të njëjtat janë konfirmuar nga eksperti shqyrtues dhe konsiderojmë që janë absolutisht të qëndrueshme. Për panelin shqyrtues do bëjë një elaborim të shkurt, që këtu janë tre parametra që këtë proces e rrezikojnë seriozisht. Parametri i parë ndërlidhet me specifikacionin e pajisjes GPS, të cilit i përgjigjet vetëm prodhuesi ARVENTO nga Turqia – asnjë prodhues tjetër nuk i përgjigjet kërkesave teknike për GPS. Parametri i dytë ndërlidhet me faktin që AK-KEK nuk ka specifikuar llojet dhe format e rezervarëve të derivateve të cilat janë parakusht themelor për definimin e llojit të senzorëve që duhet të instalohen, e rrjedhimisht kostos respektive. Pra në këto rrethana është e pamundshme të definohet se çka ka me furnizu dhe sa do të kushtoj aj furnizim. Ndërsa parametri i tretë konsiston në faktin që AK-KEK e ka definuar vlerën minimale të referencës përkitazi me këtë punë, e që në dekadën e fundit vlera të tilla për këso punë nuk janë realizuar në Kosovë. Pra nuk e plotëson asnjë OE, prandaj në shërbim të zbatimit të LPP-së dhe shëndetit të kësaj kontrate e përfitimit të AK-së kërkojmë nga paneli që të aprovohet ankesa e jonë bazuar në faktet e dorëzuara dhe këto që u thanë në këtë seancë".

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-KEK, ka deklaruar: "Ankesa ka të bëjë me specifika teknike, ne kundërshtojmë pretendimet e OE ankues dhe njëkohësisht raportin e ekspertit shqyrtues. Lidhur me pretendimet për një favorizim të një prodhuesi, ne kemi përgatitur një raport që i ofroj panelit dhe kundërshtojmë këtë pretendim pasi së paku janë 3 prodhues të pajisjeve gjurmuese me specifika teknike që plotësojnë kandidat. Gjatë shkëmbimit dhe ankesave të OE ankues, kemi gjetur disa prodhues që plotësojnë specifikat. Të gjitha provat e ofruara nga OE ankues i kundërshtojmë një nga një, shih dokumentin e bashkangjitur dhe OE i referohet një dokumenti për një prodhues që është User Guide e cila ndryshon nga Data Sheet, pasi Data Sheet ka të dhënat e përditësuara – të fundit. Prodhuesi tjetër Quec Link GV 200, po ashtu sipas nesh plotëson gjitha konditat të kundërshtuara nga OE ankues. Mirëpo për të ecur procesi e jo për të përshtatur ofertat, ne jemi të gatshëm të diskutojmë këto katër pika të cilat sipas nesh nuk qëndrojnë. Pika dytë që është shumë e rëndësishme, ka gati dy vite që shtyhet ky proces, OE PBC ka qenë më herët OE më i lirë dhe është ankuar, ndërsa në seancë është tërhequr pasi nuk ka pas deklaratën e prodhuesit. Kushtet e tenderit janë të pandryshueshme si tani si herën e mëparshme. Për rezervarët e naftës, ne nuk kemi shumë makina që dalin në terren , dhe me rëndësi është pjesa rezervarëve dhe makinerive të rënda. Po në rast se zgjatet me këto ankesa që për ne janë të pabazuara, ne kemi dhënë të gjitha informata-të dhënat që posedojmë për këto pajisje-rezervarë dhe nuk kemi dokumentacion teknik më shumë për të dhënë informata më shumë për këto pajisje. Me qenë se edhe pot përsërisim edhe njëqind here këtë proces ne si AK nuk mund të sigurojmë të dhëna më shumë, i kemi ofruar OE-ve mundësi për vizitë. Çdo shtyrje të mëtejme do shkaktoj humbje të mëtutjeshme për AK-KEK".

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues, ka deklaruar: "Lidhur me kriteret ankesa e OE ankues është e bazuar. Vetëm lidhur me nenin 108/A ankesa nuk qëndron pasi AK- i është përgjigjur dhe i ka refuzuar ankesën. Sa i përket pretendimit lidhur me rezervarët – konkretisht, dihet se senzori në rezervarë duhet ketë gjitha paramasat si janë : lloji, gjerësia, forma etj. Për këtë AK – KEK nuk ka siguruar informata OE-ve të interesuar me arsyetim se nuk kanë tjera të dhëna. I rekomandoj panelit shqyrtues që lidhur me këtë AK ka mund të organizoj që gjatë vizitës të organizoj edhe matjen e këtyre rezervarëve pasi patjetër duhet të kemi njohuritë lidhur me këta rezervarë. Nuk mund të ofrohet senzor nëse nuk dihen specifikat e rezervarit që janë elemente bazike. Po ashtu sa i përket specifikacionit të cilin OE pretendon se i përshtat vetëm prodhuesit nga Turqia, AK-KEK duhet të ketë parasysh pasi specifikacioni është i veçante, që ti jep mundësinë pjesëmarrësve dhe OE-ve të interesuar duke eliminuar ato kritere të cilat disa OE nuk mund të ofrojnë-ofertojnë dhe me këto specifika ngushtohet konkurrenca. Pretendimi në përgjigje të parashtresës për rishqyrtim nuk qëndron, për faktin se AK-KEK i është përgjigjur OE ankues duke i refuzuar ankesën konfrom nenit 108/a".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues, ka deklaruar: "Problemi me diskriminim janë disa kërkesa që fare nuk hyjnë në punë për implementim të kontratës. Kësaj kategoria është kërkesa për kushte atmosferike ku duhet ajo pajisje me i përballu temperaturës 75 gradë celsius, ndërsa 75 grade temperatura nuk ka arritur prej kur maten temperaturat. Është një kërkesë psh për 50 kanale, kur botërisht dihet se janë 7 satelit. Sikur të ishte kërkese deri 50 kanale do ishte në rregull. Kërkesë është që pajisja të punoj mes 9 deri 30 volt, ndërsa vet AK-KEK i ka me 12 ose 24 volt, dhe çfarë i nevojitet 30 volt nëse nuk m ka me i hy në punë. Arvento të cilit prodhuesi

përshtatet specifikacioni ka dërguar 3 vite më herët pajisjet dhe ka bërë pilot projektet, dhe në këtë rast pretendon me kontraktu këtë kontratë për të nxjerr shpenzimet e para tri viteve. Me buxhetin e destinuar nuk mund të blihen nga vet prodhuesit që i janë përshtat specifkacionet".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-KEK ka deklaruar: "Lidhur me pretendimin për temperaturë 75 gradë, këto do vendosen afër pajisjeve makineri e rëndë ku temperatura mund të arrijë jo vetëm 75 gradë por edhe më shumë. OE ankues duket se nuk ka përvojë për pjesën më të rëndësishme për ne si AK, për pajisjet e rënda. Ne jemi të gatshëm të rregullojmë kërkesat e AK mirëpo jo në kuptimin që të favorizohet OE ankues".

Në fjalën përfundimtare eksperti shqyrtues ka deklaruar: "AK duhet të kenë parasysh kriteret dhe nuk lejohet kërkesë si ajo për referencën derisa dihet që në Kosovë nuk ka pas furnizim të tillë, dhe kjo është kundërshtim me legjislacion të prokurimit publik. Qëndroj pranë raportit të ekspertizës së datës 01.03.2017".

Paneli shqyrtues, duke u bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, në pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues, raportin e ekspertit të OSHP-së, si dhe në të gjitha dëshmitë e prezantuara në seancën dëgjimore konstaton se autoriteti kontraktues parametrin e parë që ndërlidhet me specifikacionin e pajisje GPS e ka parashikuar në atë mënyrë që i përgjigjet vetëm prodhuesi Arvento nga Turqia, ndërsa asnjë prodhues tjetër nuk i përgjigjet kërkesave teknike për këtë pajisje. Prandaj në rastin konkret AK-ja ka përpiluar specifikime teknike ku ka kufizuar qasjen e OE të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit, duke kufizuar konkurrencën në kundërshtim me nenin 28 dhe 7 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK-ja nuk ka përcaktuar specifikimet teknike të sakta në lidhje me pajisjet si rezervuaret e derivateve, duke mos u mundësuar OE-ve të kenë informata të mjaftueshme në lidhje me rezervarët e derivateve si llojin, gjerësinë dhe formën, ku përmes këtyre do të gjenin modelet e makinerive duke definuar prodhuesit e tyre dhe do të definoheshin llojet adekuate të senzorëve për këto pajisje, paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenin me neni 28 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 20 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP), duke mos përshkruar kërkesat dhe specifikimet teknike qartë, saktë, precize dhe jodiskriminuese, prandaj ky pretendim i OE ankues është i qëndrueshëm.

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 28 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 20 paragrafi 3 dhe 4 i RRUOPP e ku parashihet që autoritetet kontraktuese duhet të përpilojnë specifika teknike të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mire për të gjithë operatorët ekonomik, pra autoritetet kontraktuese janë të ndaluara që të hartojnë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që në të ardhmen, me rastin e hartimit dhe përpilimit të specifikimeve teknike ti ketë parasysh dispozitat e lartcekura të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Korporata Energjetike e Kosovës"

1x1 OE – "PBC Sh.p.k" - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.